



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 8

Tiranë – E hënë, 1 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 3843, datë 24.2.2021	Për shitje me ankand të pronës shtetërore, në administrim të Ministrisë së Brendshme..... 3
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 1882, datë 25.2.2021	Për shpalljen e shtatë vendeve vakante për pozicionin e Këshilltarit ligjor në këtë institucion..... 4
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 1883, datë 25.2.2021	Për shpalljen e një vendi vakant për pozicionin e Specialistit të Sekretarisë Gjyqësore në këtë institucion..... 4
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 1100/6, datë 26.2.2021	Për shprehjen e interesit për provimin e pranimit në trajnimin fillestar, pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve..... 5



NJOFTIM
Nr. 3843, datë 24.2.2021

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
 PRONËS SHTETËRORE, NË
 ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË
 BRENDSHME**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret

e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo që transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Brendshme

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)				Sipër-faqja e përgjithshme (m ²)	Sipër-faqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e shitjes (mjete kryesore + mjete xhiroje)	Mjetet kryesore	Mjetet e xhiros	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Posta e policisë Dukagjin	Breg Lumi, qarku i Shkodrës	2 902 734	2 801 063	0	101 671	347	347	24.3.2021	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, në datën dhe në orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare, që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete

kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfutur kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr



pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM

Nr. 1882, datë 25.2.2021

PËR SHPALLJEN E SHTATË VENDEVE VAKANTE PËR POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË KËTË INSTITUCION

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar)).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 16 mars 2021, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hënë – të premte, ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

NJOFTIM

Nr. 1883, datë 25.2.2021

PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT TË SEKRETERISË GJYQËSORE NË KËTË INSTITUCION

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit të Sekretarisë Gjyqësore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në Drejtësi.

b) të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

c) të kenë të paktën një vit përvojë pune në profesion.



Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188 datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 8 mars 2021, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hënë – të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

KËRKESË

Nr. 1100/6, datë 26.2.2021

PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR PROVIMIN E PRANIMIT NË TRAJNIMIN FILLESTAR, PRANË QENDRËS SHQIPTARE TË TRAJNIMIT TË NOTERËVE

Në zbatim të pikës 3, të nenit 6, të nenit 90, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”; të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 534, datë 20.10.2020, “Për miratimin e rregullores për mënyrën e organizimit të provimit të pranimit në formimin fillestar”; si dhe të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë nr. 5, datë 23.2.2021, “Për përcaktimin e numrit të kandidatëve për noterë që do të pranohen në programin e formimit fillestar”, Ministria e Drejtësisë shpall në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare thirrjen për shprehjen e interesit, për provimin e pranimit në trajnimin fillestar.

1. Kandidati që kërkon të përfshihet në provimin e pranimit në trajnimin fillestar, të organizuar pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

ç) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik, për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm;

d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave” ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për Drejtësi jashtë shtetit, të njësuara në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

2. Kandidati i interesuar, për t'u përfshirë në provimin e pranimit në trajnimin fillestar, duhet të depozitojë me postë në adresën e Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, rruga “Nikolla Tupe”, pallati nr. 7, Tiranë, dhe në



rrugë elektronike, në adresën: qshtn@nisa.al, dokumentacionin vërtetues të plotësimit të kushteve, si më poshtë:

- a) 2 fotografi;
- b) kopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);
- c) kopjen e diplomës së Fakultetit të Drejtësisë dhe të certifikatës së notave, sipas ligjit “Për arsimin e lartë”, të njësuar me origjinalin ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për Drejtësi jashtë shtetit, të njësuara në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) dëshminë e penalitetit;
- e) vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria e vendbanimit se nuk është në hetim ose në gjykim për kryerjen e një vepre penale;
- f) kopjen e librezës së punës, nëpërmjet së cilës vërtetohet nëse ka qenë ose është në marrëdhënie pune, shoqëruar me vërtetimin nga punëdhënësi i fundit që nuk ka masë disiplinore në fuqi. (Ky dokument vlen për individët të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie pune.)

3. Kandidatët e interesuar duhet të përcjellin dokumentacionin e kërkuar brenda datës 17.3.2021.

4. Qendra e Trajnimit administron shprehjet e interesit të të interesuarve për noterë dhe ia përcjell ato Dhomës, e cila informon ministrin e Drejtësisë për shprehjet e interesit të paraqitura.

5. Provimi i pranimit në formimin fillestar organizohet nga Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve, në përputhje me parashikimet e ligjit për noterinë dhe të Rregullores për mënyrën e organizimit të provimit të pranimit në formimin fillestar.

6. Provimi bazohet në procedura transparente, metoda vlerësimi të drejta dhe të

besueshme dhe në një nivel të lartë të njohurive profesionale të të interesuarve.

7. Data, ora dhe vendi i provimit të pranimit në formimin fillestar caktohen me vendim të Këshillit të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Vendimi bëhet publik të paktën 3 (tre) muaj përpara datës së provimit, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

8. Komisioni i Kualifikimit përgatit provimin e pranimit në formimin fillestar, vlerëson njohuritë e të interesuarve në provimin e pranimit në formimin fillestar dhe i rendit ata në bazë të rezultateve të provimit. Konsiderohen se kanë kaluar me sukses provimin e pranimit në formimin fillestar të interesuarit e renditur sipas kësaj pike, të cilët kanë marrë të paktën 80% të pikëve të provimit, deri në përmbushjen e numrit të caktuar nga udhëzimi i përbashkët, i nxjerrë sipas pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 110/2018.

9. Rezultatet e provimit të pranimit në formimin fillestar, për të gjithë të interesuarit, bëhen publike brenda 10 ditëve nga data e dhënies së provimit, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Noterisë, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. I interesuari mund t’i nënshtrohet provimit të pranimit në formimin fillestar deri në 3 herë. I interesuari që kalon me sukses provimin e pranimit në trajnimin fillestar merr certifikatën e kalimit me sukses të provimit të pranimit në formimin fillestar.

11. Kundër vlerësimit të Komisionit të Kualifikimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2021